



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

**Kryetarja e Komunës**

**01nr \_\_\_\_\_ 2015**

**Dt: 13.03.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11,13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, e në harmoni me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, si dhe Përfundimit nr. 06-16174-4/1 i miratuar nga Bordi i Drejtorëve me dt. 26.02.2015, me të cilin është miratuar propozimi për formimin e Komisionit për përgatitjen e kriterëve dhe kompletimin e dosjeve të rasteve sociale për periodën 2015-2017, e miraton këtë:

**V E N D I M**

**I.** Formohet Komisioni për përgatitjen e kriterëve dhe kompletimin e dosjeve të rasteve sociale për Programin tre Vjeçar të Banimit për periodën 2015-2017, në këtë përbërje:

1. Z. Ali Tafarshiku, kryesues i Komisionit
2. Znj. Vjollca Shyti, anëtare
3. Z. Ukë Komani, anëtar
4. Z. Selman Sahiti, anëtar
5. Z. Jakup Hasi, anëtar

**II.** Komisioni ka për detyrë të bënë përgatitjen e kriterëve, verifikimin dhe kompletimin e dosjeve të rasteve sociale në harmoni me Ligjin nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, duke përcaktuar grupet e familjeve sipas gjendjes ekonomike të tyre, numrin dhe kategorinë e familjeve që do të përfitojnë banesa me qira, sigurimin dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë për ndërtimin e banesave , numrin dhe llojin e banesave dhe planin e banimit.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**IV.** Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Arkivit

**Kryetarja e Komunës**

**Znj. Mimoza Kusari-Lila**

